

#ourmedia

MEDIA ACTIVISM HANDBOOK




SEENPM

South East European Network
for Professionalisation of Media

#ourmedia

MANUAL I AKTIVIZMIT MEDIAL

Tijana Bumbic



Mediat dhe komunikimet sot përbëjnë një fushë kritike të betejave moderne politike. Çështjet si ndikimi i politikave redaktoriale, përqendrimi i pronësisë, siguria dhe mbikëqyrja e informacionit, cilësia e informacionit dhe roli i platformave të mediave në diskursin publik janë bërë pika qendrore të diskutimit. Mediat demokratike nuk janë thjesht kanale komunikimi, por parakushte për demokracinë. Në regjimet shtypëse, gazetaria e pavarur vepron nën presion ose zhduket plotësisht. Kriza mediale - ku mediat shpesh janë të kapura nga interesat e korporatave dhe ato politike - është globale.

Trendet globale të polarizimit, luftërat në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme, ndryshimet teknologjike dhe dominimi i platformave të mëdha të teknologjisë rrezikojnë më tej gazetarinë e pavarur dhe cilësore. Së këndejmi, aktivizmi medial bëhet thelbësor për të mbështetur vlerat e interesit publik në media dhe komunikime.

Qëllimi i këtij manuali është të hartojë praktikat e mira të aktivizmit medial për të frymëzuar aktivitete për mbrojtjen e interesit publik në media dhe

KJO PRAKTIKISHT NËNKUPTON:

- Fuqizimin e individëve për të vlerësuar në mënyrë kritike përmbajtjen mediale.
- Promovimin e gazetarisë etike dhe lirisë së mediave.
- Avokimin e programeve të fuqishme të edukimit medial.
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet edukatorëve, gazetarëve dhe aktivistëve.



EDUKIMI MEDIAL DHE INFORMATIV

Edukimi medial u mundëson individëve të qasen, analizojnë, vlerësojnë dhe krijojnë përmbajtje mediale në formate të ndryshme. Ky edukim përfaqëson aftësitë funksionale të individëve në shekullin XXI. Edukimi medial është aftësi kryesore për luftimin e keqinformimit, ndërtimin e shoqërive të informuara dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive në proceset demokratike.

AFTËSITË QË MBULON EDUKIMI MEDIAL:

- Të kuptuarit e paragjykimëve, stereotipeve dhe vendosjes së agjendave.
- Njohjen e pasojave të aktiviteteve online - gjurmët digjitale.
- Të menduarit kritik – vlerësimin e burimeve dhe verifikimin e vërtetësisë së informacionit.
- Të kuptuarit e kodeve dhe etikës së gazetarisë.

Q'ËSHTË AKTIVIZMI MEDIAL?

Aktivizmi medial përfshin një sërë aktiviteteve që synojnë reformimin e institucioneve, politikave dhe praktikave mediale, si dhe krijimin e mediave alternative të cilat promovojnë vlerat demokratike. Aktivizmi mund të analizohet nëpërmjet kornizave të ndryshme teorike, duke përfshirë lirinë e mediave, demokratizimin e mediave, të drejtat e komunikimit, të drejtën e mediave dhe mjedisin kulturor.

Aktivistët medialë kërkojnë të ndikojnë në politikat e mediave, pavarësinë e mediave, strukturën e mediave dhe përmbajtjen duke përdorur taktika siç është presioni ndaj mediave, rritja e ndërgjegjësimit të publikut, avokimi për diversitet në media dhe mbështetja e mediave alternative me integritet. Aktivizmi medial mbulon një gamë të gjerë çështjesh që lidhen me mediat, duke përfshirë komunikimin në platforma që nuk janë ekskluzivisht gazetareske. Qëllimi i tij është të angazhojë grupe të ndryshme të synuara, si

KOMPONENTËT E AKTIVIZMIT MEDIAL

- **Avokimi i politikave mediale** - Aktivistët punojnë për të ndryshuar kornizën ligjore, në mënyrë që të sigurojnë lirinë dhe pavarësinë e mediave.
- **Ndërtimi i kapaciteteve** - Organizohen trajnime për gazetarët dhe punëtorët medialë, me qëllim rritjen e aftësisë së tyre për të raportuar në mënyrë kritike dhe etike.
- **Fushatat e edukimit medial** – Kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të bërë dallimin ndërmjet lajmeve të rreme, propagandës dhe manipulimit.
- **Mbështetja për mediat alternative** - Krijohen platforma që lejojnë përfaqësimin e zërave të marginalizuar.



PSE DUHET TË PËRFSHIHEM NË AKTIVIZMIN MEDIAL?

Aktivizmi medial ka një histori të gjatë, që përfshin kontekste të ndryshme gjeografike dhe politike. Qysh në vitet 1920, aktivistët në Shtetet e Bashkuara avokonin për një sektor medial jofitimprurës. Gjatë viteve 1960 dhe 1970 lëvizjet për të drejtat e afroamerikanëve dhe grave u përqendruan në çështjet që lidhen me mediat dhe komunikimin. Lëvizjet antikapitaliste nga Bota e Tretë ishin forcë shtytëse prapa Rendit të Ri Botëror të Informacionit dhe Komunikimit (NWICO) në vitet 1970 dhe 1980. Shembuj të ngjashëm të aktivizmit janë parë në Brazil, Kore dhe pjesë të tjera të botës.

Aktivizmi medial është i rëndësishëm edhe kur kemi të bëjmë me tema që nuk lidhen drejtpërdrejt me mediat, pasi mediat luajnë rol kyç në formimin e opinionit publik dhe tërheqjen e vëmendjes ndaj çështjeve sociale.

Edhe nëse fokusi juaj kryesor është "ekologjia" ose "të drejtat e grave", këtu

PSE?

Dukshmëria e çështjes: Nëpërmjet aktivizmit medial ju mund të arrini audiencë më të gjerë dhe ta bëni temën tuaj - qoftë për çështje mjedisore apo të drejtat e grave - më të dukshme dhe të pranishme në publik në mënyrën e duhur.

Luftimi i dezinformimit: Të dy temat e lartpërmendura shpesh janë pre të dezinformimit dhe manipulimit. Aktivizmi medial ju mundëson të shpërndani informacion të saktë dhe të kundërshtoni narrativat që zvogëlojnë rëndësinë e këtyre çështjeve.

Mbështetja: Fushatat mediale të dizajnuara mirë ndihmojnë në angazhimin e komuniteteve, marrin mbështetje për qëllimet tuaja dhe ushtrojnë presion mbi vendimmarrësit.

Lidhja e temave: Mediat janë mjet i fuqishëm për të nxjerrë në pah ndërlidhshmërinë e çështjeve. Për shembull, kriza klimatike ndikon në të drejtat

Mos harroni se gazetarët që e bëjnë punën e tyre me përgjegjësi dhe pa pengesa "përfaqësojnë zërin e atyre që nuk kanë zë" dhe, kështu, lufta për media të lira dhe media me integritet është luftë për të gjithë ne.

Si aktivist, qëllimi juaj është që mesazhi juaj të dëgjohet. Aktivizmi medial është vegël, e cila ndihmon që tema juaj të lëvizë përtej një rrethi të ngushtë ekspertësh dhe të arrijë audiencë më të gjerë, duke krijuar kështu hapësirë për ndryshim. Për më tepër, avokimi për punë të besueshme dhe të përgjegjshme në media u ndihmon individëve dhe mediave të adresojnë çështje të rëndësishme për ju, pa pengesa dhe me mbështetjen e komunitetit. Presionet e shpeshta ndaj gazetarëve krijojnë mjedis shumë të pafavorshëm në të cilin individët (gazetarët) duhet të punojnë në interesin tonë.

- **Përdorimi i platformave:** Hapni llogari në mediat sociale, blogje ose nisni fushata në kanalet ekzistuese të mediave sociale, që avokojnë qasje të përgjegjshme të mediave ndaj temave që tashmë i adresoni.

- **Edukoni dhe informoni:** Krijoni përmbajtje që u ndihmon njerëzve ta kuptojnë temën tuaj. Theksoni manipulimet e pranishme në temën tuaj dhe dëmin që ato shkaktojnë. Mbështetni mediat që bëjnë punën e tyre me përgjegjësi, duke nxjerrë në pah shembuj të mirë.

- **Partneritetet me gazetarët:** Krijoni bashkëpunim me gazetarë ose organizata mediale, të cilat e kryejnë punën e tyre në mënyrë profesionale.

- **Avokimi për edukimin medial:** Duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit medial, mësoni njerëzit se si t'i dallojnë manipulimet dhe dezinformatat në lidhje me temat tuaja. Po ashtu, ofroni mbështetje për gazetarët e përgjegjshëm, puna e të cilëve do të njihet.

MEDIAT E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE TURQISË

Një raport i organizatës Human Rights Watch, i bazuar në intervistat me 86 gazetarë, thotë se gazetarët në Ballkanin Perëndimor punojnë në mjedis armiqësor, i cili ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e tyre për të raportuar në mënyrë kritike dhe të pavarur – gjë që është thelbësore për një shoqëri demokratike. Raporti 69-faqësh me titull "Profesion i vështirë: Liria e mediave, cak i sulmit" dokumenton sulme fizike dhe kërcënime, duke përfshirë kërcënime me vdekje, padi që synojnë ndëshkimin dhe fushata njollosëse që targetojnë gazetarët në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kosovë dhe Serbi.

Sipas këtij raporti, mediat e pavarura në Turqi kryesisht veprojnë nëpërmjet platformave online. Autoritetet rregullisht urdhërojnë largimin nga interneti të përmbajtjes kritike ose raporteve negative në lidhje me ministrat e qeverisë, presidentin dhe pjesëtarët e gjyqësorit. Gazetarët përballen me ndjekje penale sipas Ligjit Kundër Terrorizmit, si dhe akuza për shpifje penale, duke përfshirë akuzën e përdorur shpesh për "fyerje të presidentit", për të cilën Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka deklaruar se nuk është në

INDEKSI I EDUKIMIT MEDIAL

Indeksi i Edukimit Medial rendit vendet në bazë të potencialit të tyre për t'i rezistuar "post-të-vërtetës" dhe pasojave të saj negative. Indeksi kombinon katër tregues kryesorë, me pesha të ndryshme, në fushat e lirisë së mediave, edukimit, besimit dhe shprehive digjitale të qytetarëve, me qëllim llogaritjen dhe renditjen e rezultateve të vendeve. Indeksi vlerëson rezistencën e mundshme ndaj efekteve negative të rënies së besimit të publikut, polarizimit politik dhe social dhe fragmentimit të mediave.

Indeksi i Edukimit Medial të Open Societe Institute Sofia (2023) përmban një instrument për matjen jo të vetë edukimit medial, por parashikues të edukimit medial me qëllim të renditjes së shoqërive në potencialin e tyre për rezistencë përballë fenomenit të

Rank (1-41)	Country	Score (100-0)	Clusters (1-5)
1	Finland	74	1
2	Denmark	73	1
3	Norway	72	1
4	Estonia	71	1
5	Sweden	71	1
6	Ireland	70	1
7	Switzerland	67	1
8	Netherlands	64	2
9	Iceland	62	2
10	Belgium	61	2
11	Germany	61	2
12	Portugal	60	2
13	United Kingdom	60	2
14	Austria	59	2
15	Czech Republic	58	2
16	Spain	58	2
17	France	57	2
18	Latvia	55	2
19	Slovenia	55	2
20	Lithuania	54	2
21	Luxembourg	53	2
22	Poland	53	2
23	Slovakia	48	3
24	Italy	47	3
25	Croatia	45	3
26	Malta	45	3
27	Hungary	41	3
28	Cyprus	39	3
29	Greece	38	3
30	Ukraine	38	3
31	Serbia	33	4
32	Moldova	32	4
33	Montenegro	32	4
34	Romania	32	4
35	Bulgaria	31	4
36	Turkey	29	4
37	Bosnia and Herzegovina	24	5
38	Albania	23	5
39	North Macedonia	22	5
40	Kosovo	21	5
41	Georgia	20	5

Finlanda kryeson Indeksën Evropian të Edukimit Medial 2023 me rezultat 74, duke siguruar vendin e parë në mesin e 41 vendeve. Shumë afër saj, Danimarka renditet e dyta me 73 pikë, e ndjekur nga Norvegjia në vendin e tretë me 72 pikë. Estonia dhe Suedia ndajnë rezultate të ngjashme, secila me 71 pikë, duke i vendosur ato në pozitat 4 dhe 5, ndërsa Irlanda zë vendin e gjashtë me 70 pikë. Renditja varion nga 1 në 41, me rezultate të matura në një shkallë nga 0 në 100, ku rezultatet më të larta tregojnë performancë më të mirë.

Në skajin tjetër të spektrit, Gjeorgjia renditet e 41-ta me rezultatin 20. Kosova pason në vendin e 40-të me 21 pikë, Maqedonia e Veriut është e 39-ta me 23 pikë dhe Bosnja dhe Hercegovina zë vendin e 38-të me 24 pikë.

HARTËZIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA

Aktivistët medialë mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh të interesit publik në lidhje me mediat dhe komunikimin. Puna e tyre përfshin tema si përfaqësimi i grupeve të pakicave në përmbajtjen mediale, promovimi i diversitetit në politikat e punësimit, mbështetja e mediave alternative, siç janë mediat e komunitetit (përfshirë kornizat ligjore dhe shpërndarjen e frekuencave të transmetimit). Përveç kësaj, ata trajtojnë çështjet si pavarësia dhe roli i transmetuesve publikë, transparenca në financimin dhe pronësinë e medias, e drejta për qasje në informacionin publik, si dhe siguria dhe mbrojtja e të drejtave të gazetarëve. Puna e tyre përfshin, gjithashtu, monitorimin e mediave për të identifikuar paragjykimet, stereotipet dhe dezinformimin, ngritjen e nivelit të edukimit medial dhe adresimin e shumë çështjeve të tjera.

Hulumtimi "Hartëzimi i praktikave më të mira në aktivizmin medial" nxjerr në pah shembuj të ndryshëm të aktivizmit medial që mund të shërbejnë si frymëzim për aktivitete dhe veprime të mëtejshme. Shikoni shembuj të

■ PLATFORMAT PËR PËRMBAJTJE ALTERNATIVE DHE SHËRBIME ALTERNATIVE TË INTERNETIT

Në shoqëritë autoritare, si dhe në kontekstin e ideologjisë dominuese neoliberales, platformat alternative ofrojnë një hapësirë të sigurtë dhe të pavarur për subversion politik dhe kundërnarrativa. Këto platforma mbështeten në punën kolektive të qytetarëve-gazetarëve dhe mund të kenë ose jo ndonjë formë të redaktimit të përmbajtjes. Shumë nga këto platforma, si Indymedia ose Mosireen, u krijuan gjatë protestave të qytetarëve dhe trazirave sociale. Shumica mbështeten në prodhimin e përmbajtjes me pjesëmarrje. Kjo kategori nërfshin edhe blogje që ofrojnë perspektiva unike nër çështje me interes publik.

RASTI INDYMEDIA (SHBA dhe më gjerë)

"Indymedia" fillimisht u shfaq si platformë për të mbuluar protestat kundër Organizatës Botërore të Tregtisë në Seattle në vitin 1999, por shpejt evoluoi në një platformë globale të drejtuar nga përdoruesit dhe demonstruesit. Ajo u krijua nëpërmjet bashkëpunimit të grupeve të drejtësisë sociale, organizatave anarkiste, socialiste, komuniste dhe ekologjike, si dhe sindikatave. Gjatë viteve 2000 shumë grupe nga e gjithë bota u bashkuan me platformën, duke arritur në 175 organizata aktive deri në vitin 2014, me qëndrime të përbashkëta antikapitaliste dhe socialiste. Platforma i mundësonte secilit të publikonte përmbajtje, me kontroll redaktorial që përfshinte heqjen e postimeve të papërshtatshme në faqen "storie të fshehura". "Indymedia" arriti ndikim global dhe zgjati rreth 20 vjet falë rrjetëzimit të grupeve lokale dhe përhapjes së qëllimeve të protestës. Megjithatë, përhapja e rrjeteve sociale komerciale çoi në mbylljen e saj, ndërsa disa platforma radikale pjesëmarrëse mbijetuan me shtrirje të kufizuar lokale.

MEDIAT E KOMUNITETIT

Kjo kategori përfshin media që raportojnë rreth dhe për komunitetet e nënpërfaqësuar, si komuna të caktuara, grupe studentësh, sindikata, komunitete të bazuara në identitete etnike, gjinore ose të tjera. Mediat e komunitetit përfshijnë pjesëtarët e këtyre komuniteteve në prodhim dhe menaxhim. Ka mënyra të ndryshme se si kuptohen mediat e komunitetit, por këtu ato shihen si media me mision të qartë, të orientuar drejt komunitetit dhe interesit publik, që përgjithësisht veprojnë sipas një modeli financiar jofitimprurës. Një model i tillë, në parim, duhet të sigurojë një izolim nga interesat tregtare dhe të caktuara politike, gjë që siguron përmbajtje më të pavarur dhe të angazhuar.

RASTI TELESTREET (Itali)

“Telestreet” është një shembull i një rrjeti grupesh lokale që ofrojnë lajme alternative për qytetarët. “Telestreet” është një lëvizje që ka origjinën në zonat metropolitane italiane, fillimisht me stacionin televiziv Orfeo, i cili transmetonte disa orë në ditë me një rreze prej 200 metrash. U themelua nga teoricieni dhe aktivisti medial Franko “Bifo” Berardi. Më vonë lëvizja u rrit dhe përfshi u pothuajse njëqind ministacione televizive në të gjithë Italinë. Këta mikrotransmetues piratë, me gamë shumë të kufizuar, u krijuan si reagim ndaj kontrollit mbi mediat nga kryeministri i atëhershëm Berlusconi. Ata mbështesin njëri-tjetrin teknikisht dhe ndajnë një arkiv online të materialeve të radio transmetimit, duke rritur kështu mbulimin në nivel nacional dhe duke siguruar infrastrukturë të qëndrueshme, pavarësisht burimeve modeste financiare dhe teknike (Renzi 2011, 36).

MEDIAT E PAVARURA

Projektet dhe platformat gazetareske që ofrojnë mbulim të pavarur të ngjarjeve në vendet e qeverisura nga qeveritë shtypëse janë pika thelbësore të rezistencës dhe luftës demokratike. Po kështu, në sistemet mediale që kryesisht kapen nga grupet e interesit politik ose ekonomik, nëpërmjet marrëdhënieve të financimit dhe pronësisë, mediat e pavarura janë të vetmet që i mbajnë autoritetet përgjegjëse dhe raportojnë për tema dhe nikënamie të nënlizhuara

RASTI KOSOVO 2.0 (Kosovë)

"Kosovo 2.0", e themeluar në vitin 2010, ofron hapësirë për narrativa alternative, analiza të thella, rrëfime personale dhe perspektiva të ndryshme. Platforma njihet për qasjen e saj unike ndaj rrëfimitarisë dhe angazhimit ndaj mendimit kritik dhe dialogut. "Kosovo 2.0" përdor multimedia, duke përfshirë tekste, ese fotografike, video dhe projekte arti, për të mbuluar një gamë të gjerë fushash tematike, duke përfshirë drejtësinë sociale, politikën, gjininë, kulturën dhe të drejtat e njeriut. "Kosovo 2.0" gjithashtu ofron një platformë për

PROJEKTET, QENDRAT DHE RRJETET RAJONALE/NDËRKOMBËTARE TË GAZETARISË HULUMTUESE

Qendrat dhe rrjetet e gazetarisë, si Konsorciumi Ndërkombëtar i Gazetarëve Hulumtues (ICIJ), Projekti i Raportimit të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (OCCRP), ose qendrat e gazetarisë hulumtuese (Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Mal i Zi), mundësojnë hulumtime të angazhuara, afatgjata, të shtrenjta dhe shpesh ndërkufitare, të cilat përndryshe do të ishin të pamundura në media të tjera për shkak të komercializimit, nënshtrimit politik ose thjesht mungesës së burimeve.

RASTI PROJEKTI DAPHNE

"Daphne" ishte një projekt i gazetarisë hulumtuese nga organizata franceze e gazetarisë "Forbidden Stories", e cila koordinoi punën e 45 gazetarëve nga 18 organizata mediale, pas vrasjes së gazetares hulumtuese malteze Daphne Caruana Galizia më 17 tetor 2017. Gazetarët mbledhën dhe ndanë një numër të madh dokumentesh e informacionesh dhe këto storie u botuan nga organizatat mediale në mbarë botën. Ky ishte projekti i parë ndërkombëtar i gazetarisë nga "Forbidden Stories", bazuar në idenë se gazetaria hulumtuese e bazuar në bashkëpunim është mbrojtja më e mirë kundër censurës. Pas nismave të shumta të gazetarisë hulumtuese, vijuan hetimet penale dhe dorëheqjet e zyrtarëve publikë. Pasi Projekti Daphne publikoi storien e vet hulumtuese, një nga vrasësit rrëfeu për vrasjen e gazetares malteze, biznesmeni i lidhur me vrasjen u arrestua dhe kryeministri dha dorëheqje, për shkak të lidhjeve mes zyrtarëve publikë dhe biznesmenit të përmendur (Simon 2023, 16).

INICIATIVA QE MBESHTETESIN MEDIA ALTERNATIVE DHE TE PAVARURA

Aktivizmi medial përfshin edhe mbështetjen e mediave alternative, të pavarura dhe hulumtuese. Kjo mbështetje mund të përfshijë përpjekje për të mbledhur fonde, për të ofruar ndihmë logjistike, teknike dhe ligjore, për të ofruar mundësi trajnimi, për të blerë

RASTI PLATFORMA NOV DAN (Slloveni)

"Nov dan" është një platformë digjitale eksperimentale, e lansuar në vitin 2022, që synon të kontribojë në qëndrueshmërinë e gazetarisë së pavarur në Slloveni, nëpërmjet mbledhjes së kontributeve financiare nga qytetarët (mbledhja e fondeve të komunitetit) për pesë media të pavarura në Slloveni – Oštro, In Media Res, Mešanec, Državljan D, Agrument – DJND. Platforma bazohet në standardin e mbledhjes së fondeve nëpërmjet webit, optimizimit të angazhimit të përdoruesve dhe testimit të strategjive të komunikimit. Ajo u zhvillua nga organizata joqeveritare "Danes je nov dan", e cila trajton çështjet si pjesëmarrja digjitale dhe aktivizmi qytetar, transparencja dhe mbikëqyrja publike. Iniciativa mbështetet nga fondacioni "Grant for the Web" me një shumë prej 46,014 USD. Si projekt crowdfunding, "Nov dan" synon t'i fuqizojë pjesëtarët e komunitetit për të mbështetur platformat dhe përmbajtjen që ata vlerësojnë dhe për të nxitur kohezion, duke e transformuar audiencën e mediave nga shikues pasivë, në pjesëmarrës aktivë. Ka edhe shembuj të tjerë të ngjashëm të mbledhjes së fondeve në rajonin e Evropës Juglindore. Ata përballen me sfida që lidhen me lexueshmërinë/dëgjueshmërinë/shikueshmërinë e kufizuar të mediave të pavarura, të ardhurat e vogla të qytetarëve dhe vështirësitë në ruajtjen e mbështetjes afatgjatë të qytetarëve. Por disa platforma (kryesisht ato që ofrojnë përmbajtje unike dhe kanë audiencë besnike) arrijnë të sigurojnë një pjesë të konsiderueshme të të

ORGANIZATA QË KËRKOJNË REFORMA MEDIALE NË FUSHËN E GJERË TË LIRISË SË SHPREHJES

Në nivel global ka organizata të shumta, të cilat zbatojnë reforma të ndryshme të lidhura me mediat, duke përfshirë kufizimin e përqendrimit të pronësisë së mediave dhe promovimin e pluralizmit të mediave, ruajtjen e mediave të shërbimit publik, sigurimin e pjesëmarrjes digjitale, mbrojtjen e privatësisë dhe kufizimin e mbikëqyrjes së qytetarëve.

RASTI FREE PRESS (SHBA)

"Free Press" është organizatë joqeveritare avokuese e mediave, e cila përbën një shembull të rritjes organizative dhe rritjes së ndikimit nëpërmjet akumulimit të punës dhe trashëgimisë së saj. E themeluar në vitin 2003 me pak punëtorë, ajo është rritur në një organizatë me më shumë se 35 të punësuar. Ndonjëherë ka ndikim të madh në politikat e Washingtonit, për shembull në lidhje me pronësinë e mediave dhe neutralitetin e rrjetit, financimin e transmetuesit publik dhe raportimin e rremë të mediave (McChesney 2009, 49). "Free Press" formon koalicione strategjike me grupe të ndryshme ideologjike, duke përfshirë, për shembull, Koalicionin e Krishterë dhe aktivistë të tjerë konservatorë, duke

AKTIVIZMI REAKTIV KUNDËR NISMAVE POLITIKE RETROGRESIVE ME KËRKESA PËR NDRYSHIME PROGRESIVE TË POLITIKAVE

Aktivizmi medial përfshin edhe veprime dhe kërkesa “ad hoc” për të ndaluar propozimet e politikave retrogresive, si dhe avokim afatgjatë të zgjidhjeve pozitive. Ky lloj aktivizmi medial mund të përfshijë protesta, letra, peticione, fushata mediale dhe diskutime me përfaqësues të sektorit publik.

RASTI I AKTIVIZMIT KUNDËR NDRYSHIMEVE TË LIGJIT PËR SHERBIMET MEDIALE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE (Shqipëri)

Në Shqipëri ka pasur përpjekje të vazhdueshme për të miratuar rregullore për përmbajtjen e mediave online. Ndryshimet më të fundit të propozuara përcaktonin se rregullatorët do të kishin kompetenca ekzekutive për të ndëshkuar dhe mbyllur mediat online, në rastet e ankesave të qytetarëve në lidhje me përmbajtjen e tyre. Shumë organizata të shoqërisë civile i kundërshtuan ndryshimet, pasi ato mund të kufizojnë lirinë e mediave, duke qenë se pavarësia e rregullatorëve nuk është e garantuar dhe masat ekzekutive janë shumë të paqarta dhe kufizuese. Mediat dhe organizatat mediale zhvilluan takime, shkruan letra dhe opinione kundër ndryshimeve, morën pjesë në diskutime me komisionin përkatës parlamentar dhe organizuan protesta para Parlamentit në dhjetor 2019, gjatë një seance plenare. Ligji u miratua. Megjithatë, veprimet e shoqërisë civile kontribuan në mobilizimin e opinionit publik ndërkombëtar dhe presionit ndërkombëtar për tërheqjen e ligjit. Komisioni i Venecias publikoi një opinion në qershor 2020, duke deklaruar se ligji ishte "i paqartë dhe ka të ngjarë të jetë dekurajues, duke mbytur diskutimin e lirë dhe fjalën politike". Që atëherë ligji nuk është zbatuar dhe organizatat e shoqërisë civile kanë vazhduar ta traitojnë atë në diskutime publike, tryeza të rrumbullakëta, intervista televizive etj. Tërheqja

AKTIVIZMI MEDIAL KUNDËR ABUZIMIT TË LIGJEVE: MONITORIMI, MBËSHTETJA LIGJORE DHE AVOKIMI PËR PARANDALIMIN E ABUZIMIT TË LIGJEVE

Ekziston një prirje e shtuar globale e përdorimit të ligjeve për të ushtruar presion mbi mediat, gazetarët, aktivistët dhe organizatat e tjera mbikëqyrëse, që njihen si padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP). Më konkretisht, kjo përfshin abuzimin e ligjeve, përfshirë shpifjen e përcaktuar me të drejtën penale ose civile, si dhe ligje të tjera si pronësia intelektuale, privatësia dhe ligjet për mbrojtjen e të dhënave, nëpërmjet padive që synojnë frikësimin, heshtjen dhe shtjerrjen e burimeve financiare dhe psikologjike të caqeve

RASTI RRJETI LIGJOR PËR MBROJTJEN E DEMOKRACISË (LNPĐ) (Slloveni)

Rrjeti u krijua gjatë pandemisë COVID-19 dhe formimit të qeverisë së udhëhequr nga Partia Demokratike Sllovene, me qëllim të ofrimit të mbrojtjes ligjore dhe sfidimit të masave kufizuese të qeverisë, si kufizimi i së drejtës për lëvizje, kufizimi i qasjes së qytetarëve në informacion dhe pjesëmarrja në proceset e vendimmarrjes, si dhe ofrimi i mbështetjes në rastet e sulmeve ndaj organeve të pavarura shtetërore, gjyqësorit, akterëve të shoqërisë civile dhe protestuesve. LNPĐ-ja u formua në fund të vitit 2020 kur "Amnesty International Slovenia", "Danes je nov dan", "PIC – Qendra e Informacionit Ligjor për OJQ-të" dhe "Institute for Cultural Diversity Open" bashkuan forcat me mbështetjen dhe bashkëpunimin e kompanive kryesore ligjore, profesorëve të juridikut dhe vullnetarëve. LNPĐ-ja ofron këshilla, paraqet ankesa në zyrat qeveritare, ndihmon në ngritjen e padive, ngre kallëzime penale kundër zyrtarëve publikë, organizon diskutime etj. Gjykata Kushtetuese ka anuluar ose kërkuar përmirësime të rregulloreve të kontestuar nga LNPĐ-ja dhe rrjeti ka demonstruar potencial të madh për solidaritet në mbrojtjen e sundimit të ligjit.

REKOMANDIME PËR AKTIVISTËT (E ARDHSHËM)

Bazuar në analizën e shembujve historikë dhe sfidave bashkëkohore, rekomandimet e mëposhtme mund të shërbejnë si udhëzues për aktivistët e ardhshëm medialë, të cilët synojnë të përmirësojnë hapësirën mediale dhe komunikimet në shërbim të interesit publik:

Përcaktoni qartë qëllimet dhe strategjitë

Orientoni aktivitetet drejt qëllimeve specifike, si demokratizimi i mediave, përmirësimi i edukimit medial, transparenca në pronësinë dhe financimin e mediave, ose promovimi i së drejtës për qasje në informacion.

Përshtatni strategjitë në kontekstin lokal, duke u mbështetur në praktika të suksesshme, si krijimi i mediave alternative, nisja e fushatave për reformën e politikave mediale ose ndërtimi i koalicioneve me organizata që mendojnë njësoj.

Rifreskoni taktikat tuaja

Është thelbësore të sigurohen të dhëna të sakta, si dhe zgjidhje praktike dhe të arritshme për problemet. Pse të mos shfrytëzoni mundësinë për një raund të ri hulumtimi? Ose të nisni një sondazh online në komunitetin tuaj, për të mbledhur të dhëna të reja që mbështesin argumentin tuaj?

Ju, gjithashtu, mund të mblidhni rrëfime nga njerëz të prekur nga raportimi negativ për një çështje të caktuar dhe t'i përdorni ato për të ilustruar qëllimin tuaj në mënyrë mbresëlënëse.

Situata mund të ketë prodhuar akterë të rinj kyçë për qëllimin tuaj, siç janë influencerët që janë të gatshëm të bashkëpunojnë me mediat. Eksploroni dhe përshtatni mesazhin dhe taktikat tuaja në përputhje me rrethanat.

Jepini formë mesazhit tuaj

Kornizimi është vegël e fuqishme komunikimi. Në varësi të kornizës që zgjidhni, mund të arrini rezultate shumë të ndryshme. Synoni t'i formësoni mesazhet tuaja të avokimit, në mënyrë që të jenë sa më bindëse për audiencën e synuar. Njohuritë kontekstuale, gjegjësisht konteksti lokal dhe kulturor, janë thelbësore.

Ndërtoni rezistencë ndaj presioneve të jashtme

Bashkëpunoni

Bashkëpunimi me individë dhe organizata të të njëjtit mendim mund të rrisë gjasat për arritjen e qëllimeve tuaja të avokimit. Zhvillimi i bashkëpunimeve të tilla kërkon të kuptuarit e hollësishëm të pikave të forta dhe të dobëta të akterëve të tjerë në këtë fushë, si dhe të organizatës suaj. Kini parasysh: kush ka kapacitete dhe lidhje komplementare, nga të cilat organizata juaj mund të përfitojë dhe anasjelltas?

Disa aspekte që duhen marrë parasysh para se të bashkëpunoni:

- A keni të njëjtin qëllim?
- A keni standarde ose praktika të ngjashme?
- Çfarë infrastrukture mund të përdorni dhe a ka mbështetje të mjaftueshme nga të dyja palët për të mbështetur përpjekjet?

Fokusohuni në edukimin medial dhe informativ

Rritni ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e aktivizmit medial dhe fuqizojini ata nëpërmjet edukimit për të kuptuar në mënyrë kritike mesazhet e mediave, duke dalluar dezinformimin dhe duke marrë pjesë në reformat e mediave.

Përdorni teknologjinë dhe inovacionin

Platformat teknologjike ofrojnë mundësi për të shpërndarë mesazhe, për të organizuar ngjarje dhe për të angazhuar qytetarët. Mediat alternative, si mediat e komunitetit ose platformat jofitimprurëse online, mund të jenë vendimtare për shpërndarjen e përmbajtjes me interes publik.

Monitoroni ndryshimet teknologjike dhe përshtatuni për të mbetur relevante dhe konkurrentë në hapësirën digjitale.

Mësoni nga shembujt historikë

Analizoni sukseset dhe dështimet e lëvizjeve të mëparshme të mediave, në mënyrë që të identifikoni qasje efektive dhe për të shmangur pengesat e zakonshme. Për shembull, fushatat për pluralizëm në Brazil dhe mobilizimi publik në Kore, siç tregohet në tabelë,

BURIMET SHITESË

SERBI	Ligji për informimin publik dhe mediat, Ligji për mediat elektronike, Ligji për transmetimin e shërbimit publik, Ligji për qasjen e lirë në informatat me rëndësi publike
BOSNJE DHE HERCEGOVINË	Ligji për komunikimet, Ligji për sistemin e shërbimit të transmetimit publik të Bosnjës dhe Hercegovinës, Ligji për lirinë e qasjes në informacion në nivelin institucional të Bosnjës dhe Hercegovinës
MAL I ZI	Ligji për mediat, Ligji për mediat elektronike, Ligji për shërbimet e transmetimit publik, Ligji për qasjen në informacion
SHQIPËRI	Ligji për shtypin, Ligji për mediat audiovizive, Ligji për qasjen në informacion
KOSOVË	Ligji për transmetuesin publik, Ligji për qasjen në dokumente publike
MAQEDONI E VERIUT TURQI	Ligji për shërbime mediale audio dhe audiovizive, Ligji për media, Ligji për qasje në informata Ligji për mediat audiovizive, Ligji për radion dhe televizionin e Turqisë, Ligji për themelimin dhe shërbimet e transmetimit të ndërmarrjeve të radios dhe televizionit, Ligji për të ardhurat e radios dhe televizionit në Turqi, Ligji për rregullimin e transmetimit në internet dhe lufta kundër krimeve të kryera nëpërmjet transmetimit në internet, Ligji për të drejtën e marrjes së informacionit



**Funded by
the European Union**

Ky publikim u krijua në kuadër të projektit Our Media. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë punim janë vetëm të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e SEENPM-së.

Projekti rajonal "Media jonë: Iniciativa për avancimin e edukimit medial, dialogut dhe aktivizmit" zbatohet me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian nga organizatat partnere SEENPM, Instituti Shqiptar i Mediave, Mediacentar Sarajevë, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Instituti Malazez i Mediave, Instituti Maqedon i Mediave, Shkolla e Gazetarisë në Novi Sad, Instituti i Paqes dhe Bianeti.

Ky artikull u prodhua me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e SEENPM-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.